

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 10/6 Prot.

Tiranë, më 31.07 2017

VENDIM Nr. 164, datë 26.07.2017


Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.10, datë 26.07.2017, pasi shqyrtoi Konceptin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit në kuadër të projektit "*Objekt multifunksional 10 kat, (2 kate shërbime dhe 8 kat banim) dhe 1 kat parkim nëntokë, ndodhur në kryqëzimin e rrugës "Mujo Ulqinaku" me rrugët "Andon Naci dhe "Hajdar Dushi" deri në ndërprerjen me rrugën "Dalip Tabaku", Durrës, zona arkeologjike "B-subjekti "RAJFI" sh.p.k. paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD -STAR" sh.p.k.,*

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e punimeve të gërmimit për "*Objekt multifunksional 10 kat, (2 kate shërbime dhe 8 kat banim) dhe 1 kat parkim nëntokë, ndodhur në kryqëzimin e rrugës "Mujo Ulqinaku" me rrugët "Andon Naci dhe "Hajdar Dushi" deri në ndërprerjen me rrugën "Dalip Tabaku", Durrës, zona arkeologjike "B", në zonën ku janë kryer sondazhet arkeologjike nga IA, nën monitorimin periodik ditor të shoqërisë së licencuar në arkeologji "AD -STAR" sh.p.k. dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.*
2. Punimet do të kryhen në vijim të aktmarrëveshjes tre palëshe Nr. 260 Prot., datë 28.02.2017.
3. Miratohet Koncepti i Gërmimit Arkeologjik të Shpëtimit i paraqitur nga kjo shoqëri, i cili do të zbatohet në rast gjetjesh që mund të dalin gjatë punimeve të gërmimit për objektin e sipërpërmendur.
4. Shoqëria e licencuar në arkeologji në rast gjetjesh, ndërpret menjëherë punimet e gërmimit për objektin e sipërpërmendur, lajmëron ASHA me qëllim *fillimin e Gërmimit Arkeologjik të Shpëtimit, sipas Konceptit të miratuar në pikën 3 të këtij vendimi.*

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO-FURXHI
MINISTËR



SEKRETARI KKA
RUDINA ZOTO

